

STATUTI
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"META RESORTS ALBANIA" SHPK

Sot më datë 22.06.2021, Ortaku Themelues:

- **Z. Dante Mazzitelli**, i biri i Orfeo, shtetas Italian, lindur më 01.01.1955, në Salerno, Itali, banues në: Rruga "Guido Dorso" nr. 19, Bari, Itali, i identifikuar me pasaportën Italiane me numër YA7912834;

I cili bazuar në vullnetin e lirë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, vendosi të nënshkruajë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky statut.

KAPITULLI I

Neni 1 - themelimi, Forma dhe Ortaku

- 1.1 Ortaku i Shoqërisë ka vendosur të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar emërtimi i së cilës do të jetë "**META RESORTS ALBANIA**" SHPK.
- 1.2 Shoqëria "**META RESORTS ALBANIA**" SHPK është krijuar si një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.3 Shoqëria do të funksionojë sipas legjislacionit shqiptar.
- 1.4 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.


Neni 2 - Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është "**META RESORTS ALBANIA**" SHPK

Neni 3 - Objekti i Shoqërisë

3.1 Objekti i shoqërisë konsiston në:

Sipërmarrja turistike në fushën e turizmit, nëpërmjet hapjes së hoteleve, fshatrave turistike, njërive të akomodimit të turistëve, bar-restoranteve si dhe tu ofroje turistëve dhe vizitorëve transport, guide dhe aktivitete argëtuese në të gjitha format; Blerja e jahteve të të gjitha përmasave dhe dhënia me qiraja e tyre për qëllime turistike; Menaxhimi në fushën e hotelerisë dhe jo vetëm; shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj edhe në import eksportin e mjeteve apo materialeve që lidhen me kryerjen e objektit kryesor të saj; Veprimtari në fushën e agrikulturës dhe çdo aktivitetet te lidhur me te; Veprimtari në fushën e rijetëzimit të godinave të tipologjive të ndryshme, kryesisht ato te trashëgimisë kulturore dhe jo vetëm; Veprimtari në fushën e projektimit dhe të ndërtimit civil, te marinave/porteve turistike/ jahtesh, kulturor, industrial, turistikë, bujqësore,



etj. Projektim pejsazhi (sistemime, lulishte, vepra arti, dekori, etj.); Kryerja e veprimtarisë tregtare në fushën e lojërave të fatit/kazino ne hotel me 5 yje e çdo lloj veprimtarie ne këtë fushë; Projektim interiere, mobilje, pajisje, dizajn industrial; punime dheu, sistemime, tarracime, prodhime elementesh te parafabrikuara betoni e betonarme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to. Rilevime topografike, punime topogjeodezike, punime në sipërfaqe të gjelbërta parqe, lulishte, instalimi i impianteve ngritëse dhe transportuese (ashensorë etj.), instalimi i impianteve të ngrohjes e ftohjes, instalimi i impianteve higjenike, instalimi i impianteve nënpresion, restaurim i ndërtesave monument kulture, punime restaurimi në vepra arkeologjike, ndërtime diga, galeri, tunele, punime mbrojtje të sistemit hidraulikcimentime, kanale e impiante vaditje, punime karpentiere druri dhe metali, kabinat e transformatorëve;

Neni 4 - Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr. 2, Kati 11, Ap. 28, Tirana, Albania.**
- 4.2. Transferimi i selisë së shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së ortakëve me shumicë të kualifikuar.
- 4.3. Asambleja e ortakëve me shumicë të kualifikuar mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Neni 5 - Kohëzgjatja e veprimtarisë


- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë **pa afat**.
- 5.2. Shoqëria mund të priset përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve me shumicë të kualifikuar.

Neni 6 - Përgjegjësia

- 6.1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti dhe Akti i Themelimit.
- 6.2. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emër të tyre personal ndaj personave fizikë ose juridikë, privatë ose shtetëror.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E KUOTAVE TË KAPITALIT

Neni 7 - Kapitali themeltar



7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1 (një) kuotë, e gjitha e nënshtuar me vlerë nominale 100 (njëqind) lekë.

Neni 8 - Kontributet

8.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- **Z. Dante Mazzitelli**, i biri i Orfeo, shtetas Italian, lindur më 01.01.1955, në Salerno, Itali, banues në: Rruga "Guido Dorso" nr. 19, Bari, Itali, i identifikuar me pasaportën Italiane me numër YA7912834.

8.2 Sipas kontributeve të mësipërme:

- Ortaku: **Z. Dante Mazzitelli**, i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondojnë 100% (njëqind për qind) të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Neni 9 - Rritja e kapitalit themeltar

9.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Shoqërisë, marrë me shumicë të kualifikuar.

9.2 Në rast të rritjes së kapitalit, kuotat e ortakëve të Shoqërisë do të rriten sipas shumave të përcaktuara në vendimin asamblesë.

Neni 10 - Zvogëlimi i kapitalit themeltar

10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Shoqërisë me shumicë të kualifikuar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

10.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve sipas shumave të përcaktuar në vendimin e asamblesë.

Neni 11 - Transferimi i kuotave të kapitalit


11.1 Kuotat e kapitalit nuk janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve ose tek të tretët. Transferimi i kuotave, në çdo lloj forme, do të autorizohet me vendim të Asamblesë së Shoqërisë, me shumicë të kualifikuar.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 12 - Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

12.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.




- 12.2 Vendimet e Asamblesë së Shoqërisë, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që përfaqësojnë me shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të të gjithë kapitalit themeltar dhe asambleja do të vendosi me votën e ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar.
- 12.3 Nëse Asambleja nuk mund të mbliidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendura në nenin 12.2 të këtij statuti, Asambleja do të mbliidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, cilido qoftë numri i ortakëve të pranishëm dhe do të vendosi me votën e shumicës së ortakëve të pranishëm, përveç emërimit dhe shkarkimit të administratorit. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 12.2.
- 12.4 Vendimet e Asamblesë së Shoqërisë, për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar janë të vlefshme nëse, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhjen e dytë, janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë te paktën ³/₄ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar.

Neni 13 - E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 13.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë vendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kapitalit të kuotave që ai zotëron.
- 13.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër edhe jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të ushtrojë të drejtën e votës.
- 13.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për një pjesë të kuotave të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur të kuotave.

Neni 14 - Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

- 14.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 14.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve ose nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se 10 % (dhjetë për qind) të kapitalit themeltar.
- 14.3 Asambleja mund të thirret nëpërmjet telefonit, njoftimit me sms, atij me email apo nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjen që do të trajtohet dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 14.4 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, brenda apo jashtë vendit.
- 14.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të



identifikohen dhe ti lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumentave. Pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet kryetari i Asamblesë.

- 14.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht dhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 14.7 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose një person tjetër i caktuar nga e njëjta Asamble. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 14.8 Vendimet e Asamblesë mund të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 15 - Administrimi

- 15.1 Shoqëria administrohet të paktën nga 1 (një) administrator dhe maksimumi 3 (tre) administratorë, të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen, për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh.
- 15.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit, apo Administratorëve bashkërisht, kur rezulton të jenë emëruar më shumë se një. Administratorët do të ushtrojnë të gjitha kompetencat sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 15.3 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh, për aq sa i është lejuar nga ky Statut apo nga akti i emërimit.

Neni 16 - Eksperti kontabël i autorizuar


- 16.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe i Librave kontabël të Shoqërisë mund ti besohet një eksperti kontabël të autorizuar.
- 16.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI - IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 17 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 17.1 Viti financiar fillon me 1 (një) janar dhe mbaron me 31 (tridhjetë e një) dhjetor të secilit vit.
- 17.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.



- 17.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe të ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja me shumicën e përcaktuar sipas ligjit 9901, datë 14,04,2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.4 Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 18 - Fitimet

- 18.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos ti verë mënjanë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 18.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.


KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 19 - Prishja

- 19.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, me vendim të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 19.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes ose falimentimit të ortakëve.

Neni 20 - Likuidimi

- 20.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 20.2 Për të administruar këtë procedure, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 20.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 20.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.



Neni 21 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


- 21.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe akti të themelimit, si dhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 21.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 22 - Gjuha

- 22.1 Ky statut është i përbërë nga 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.
- 22.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statut dhe aktit të themelimit, versioni në gjuhën shqipe do të jetë e vetmja ligjërish e pranueshme.

ORTAKU I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"META RESORTS ALBANIA" SHPK



Z/ Dante MAZZITELLI

AKT - THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“META RESORTS ALBANIA”

Ortaksi i vetëm i Shoqërisë “**META RESORTS ALBANIA**” SHPK, është:

1. **Z. Dante Mazzitelli**, i biri i Orfeo, shtetas Italian, lindur më 01.01.1955, në Salerno, Itali, banues në: Rruga “Guido Dorso” nr. 19, Bari, Itali, i identifikuar me pasaportën Italiane me numër YA7912834;

VENDOSI:

Neni 1

Të themelojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar të quajtur:
“**META RESORTS ALBANIA**” SHPK.

Shoqëria është një subjekt juridik shqiptar, të cilës i lind e drejta të ushtrrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Shoqëria “**META RESORTS ALBANIA**” SHPK zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

Neni 3

“**META RESORTS ALBANIA**” SHPK ka selinë e saj në Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla Nr. 2, Kati 11, Ap. 28, Tirana, Albania.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjenci përfaqësimi, seli sekondare, degë, si dhe ti suprimojë ato.

Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të krijojë, apo të jetë pjesë e një apo më shumë shoqërive tregtare, pavarësisht nga statusi i tyre juridik, me një pjesëmarrje që do të përcaktohet në çdo rast nga Asambleja e Ortakëve.


Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë **pa afat**. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë në përputhje me dispozitat statutore dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë “**META RESORTS ALBANIA**” SHPK do të jetë 1 (një) kuotë, në vlerën 100 (njëqind) lekë, me kontributet 100% të ortakut të vetëm.

Emri	Përqindja	Kuota	Kontributi në lekë
------	-----------	-------	--------------------



Neni 6

Kapitali themeltar është tërësisht në para. Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë tërësisht të derdhura dhe të nënshkruara nga ortakut themelues. Rritja e kapitalit të shoqërisë nuk është e kufizuar.

Neni 7

Objekti i shoqërisë do të jetë:

Sipërmarrja turistike në fushën e turizmit, nëpërmjet hapjes së hoteleve, fshatrave turistike, njësive të akomodimit të turistëve, bar-restoranteve si dhe tu ofroje turistëve dhe vizitorëve transport, guide dhe aktivitete argëtuese në të gjitha format; Blerja e jahteve të të gjitha përmasave dhe dhënia me qiraja e tyre për qëllime turistike; Menaxhimi në fushën e hotelerisë dhe jo vetëm; shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj edhe në import eksportin e mjeteve apo materialeve që lidhen me kryerjen e objektit kryesor të saj; Veprimtari në fushën e agrikulturës dhe çdo aktivitetet te lidhur me te; Veprimtari në fushën e rijetëzimit të godinave të tipologjive të ndryshme, kryesisht ato te trashëgimisë kulturore dhe jo vetëm; Veprimtari në fushën e projektimit dhe të ndërtimit civil, te marinave/porteve turistike/ jahtesh, kulturor, industrial, turistikë, bujqësore, etj. Projektim pejsazhi (sistemime, lulishte, vepra arti, dekori, etj.); Kryerja e veprimtarisë tregtare në fushën e lojërave të fatit/kazino ne hotel me 5 yje e çdo lloj veprimtarie ne këtë fushë; Projektim interiere, mobilje, pajisje, dizajn industrial; punime dheu, sistemime, tarracime, prodhime elementesh te parafabrikuara betoni e betonarme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to. Rilevime topografike, punime topogjeodezike, punime në sipërfaqe të gjelbërta parqe, lulishte, instalimi i impianteve ngritëse dhe transportuese (ashensorë etj.), instalimi i impianteve të ngrohjes e ftohjes, instalimi i impianteve higjenike, instalimi i impianteve nënpresion, restaurim i ndërtesave monument kulture, punime restaurimi në vepra arkeologjike, ndërtime diga, galeri, tunele, punime mbrojtje të sistemit hidraulikcimentime, kanale e impiante vaditje, punime karpentiere druri dhe metali, kabinat e transformatorëve;

Neni 8


Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues mbartin rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë në masën e kapitalit të investuar në Shoqëri.

Neni 9

Organet e shoqërisë "**META RESORTS ALBANIA SHPK**" janë:

- Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.
- Administratorët e shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.




Administratori i shoqërisë do të jetë **Z. Dante Mazzitelli**, i cili do të ushtrojë kompetencat e administratorit, për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Ky afat mund të ndryshojë lirisht në çdo moment që konsiderohet e nevojshme nga asambleja e ortakëve.

Modalitetet për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti i shoqërisë, ligji 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky Akt - Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

ORTAKU I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"META RESORTS ALBANIA" SHPK



Z. Dante MAZZITELLI

Datë 22.06.2021